



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. _____/2024

**PËR
DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8952, DATË 10.10.2002, “PËR
LETËRNJOFTIMIN ELEKTRONIK TË SHTETASVE SHQIPTARË”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI

Në ligjin nr. 8952, datë 10.10.2002, “Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në titullin e ligjit, pas fjalës “elektronik” shtohet togfjalëshi “dhe digjital”.

Neni 2

Në nenin 1, pas togfjalëshit “letërnjoftim unik,” shtohet togfjalëshi “elektronik ose digjital”.

Neni 3

Në nenin 2, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë:

1. Në pikën 1, pas fjalisë së parë, shtohen fjalitë me këtë përmbajtje: “Letërnjoftimi mund të jetë në formë elektronike ose digjitale. Në çdo rast, shtetasit mund të zgjedhin për t’u pajisur me një nga format e letërnjoftimit, ose mund të pajisen njëkohësisht me letërnjoftimin në të dy format, elektronike dhe digjitale.”.

2. Pika 3 dhe 4, shfuqizohen.

3. Pika 5, ndryshohet si më poshtë:

“5. Rregullat dhe procedurat për paraqitjen e kërkesës për pajisjen me letërnjoftimin elektronik dhe digjital, si dhe dokumentet e nevojshme që shoqërojnë kërkesën, përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Brendshëm.”

Neni 4

Në nenin 3, në pikën 2, pas fjalisë së parë, shtohet fjalia me këtë përmbajtje: “Shtetasit që nuk kanë mbushur moshën 16 vjeç, sipas parashikimit të pikës 1, shkronja “b” e këtij neni, kanë të drejtë të pajisen me letërnjoftim me kërkesë të prindërve ose kujdestarit të tyre.”

Neni 5

Në nenin 4, në paragrafin e parë dhe në paragrafin e dytë, fjala “elektronik” shfuqizohet.

Neni 6

Neni 5, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Neni 5

Shtetasi pajiset me letërnjoftim të ri kur plotëson kushtet e nenit 3 të këtij ligji dhe:

- a) njëri nga përbërësit e gjendjes civile, të pasqyruar në letërnjoftim, ka ndryshuar, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi; ose
- b) vërtetohet nga organet përkatëse se letërnjoftimi i ka humbur ose i është vjedhur; ose
- c) është dëmtuar; ose
- ç) në çdo rast tjetër që parashikohet nga legjislacioni në fuqi.”

Neni 7

Në nenin 5/1, shkronja “b” ndryshohet si më poshtë vijon:

“b) vërtetohen rastet e përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji”.

Neni 8

Në nenin 6 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Paragrafi i parë numërohet me numrin 1 dhe në paragrafin e parë, pas fjalës “Letërnjoftimi”, shtohet fjala “elektronik”.

2. Pas paragrafit të parë, shtohet pika 2 dhe 3, me këtë përmbajtje:

“2. Letërnjoftimi digjital është dokument identiteti, në të cilin janë pasqyruar qartë dhe shënuar me metoda digjitale të gjitha elementët e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni. Përveç elementëve të pikës 1, të këtij neni, në letërnjoftimin digjital përfshihen edhe:

- a) çelësi kriptografik që mundëson identifikimin digjital dhe certifikatën përkatëse;
- b) informacioni që mundëson nënshkrimin digjital, duke përfshirë një çelës kriptografik që mundëson nënshkrimin digjital dhe certifikatën përkatëse;
- c) të dhëna të tjera digjitale.

3. Të dhënat e tjera digjitale që përfshihen në letërnjoftimin digjital, sipas shkronjës “c”, të pikës 2, të këtij neni, përcaktohen me udhëzim të ministrit të Brendshëm.”

Neni 9

Pas nenit 6, shtohet neni 6/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 6/1

1. Letërnjoftimi digjital mund të prodhohet nga shoqëria aksionare përgjegjëse për prodhimin dhe shpërndarjen e dokumenteve biometrikë vetë ose në bashkëpunim me shoqëri të tjera që kanë eksperiencën dhe kapacitetet teknike dhe financiare për prodhimin e letërnjoftimeve digjitale.

2. Rregullat dhe procedurat për përzgjedhjen e shoqërive që mund të bashkëpunojnë me shoqërinë aksionare përgjegjëse për prodhimin dhe shpërndarjen e dokumenteve biometrik për prodhimin e letërnjoftimeve digjitale përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 10

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave për miratimin e aktit nënligjor të parashikuar në pikën 2, të nenit 6/1 brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Ngarkohet Ministri i Brendshëm për miratimin e akteve nënligjore të parashikuara në pikën 5, të nenit 2 dhe pikën 3, të nenit 6, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

LINDITA NIKOLLA